

TAKIMI I PARË 2026 - KOMITETI SEKTORIAL I BUJQËSISË

Takimi i parë i Komitetit Sektorial të Bujqësisë u mbajt më datë **08.06.2026**.

Takimi u hap nga Drejtoresha e Përgjithshme e AKAFPK-së, e cila u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve dhe falënderoi anëtarët për kontributin e tyre në sektorin e bujqësisë, si dhe gatishmërinë e treguar për të bashkëpunuar në funksion të Komitetit Sektorial. Gjatë fjalës hyrëse, u vu në dukje rëndësia e Komitetit Sektorial, si një mekanizëm që lidh arsimin dhe formimin profesional me kërkesat e tregut të punës dhe rolin strategjik të sektorit të bujqësisë në zhvillimin ekonomik të vendit. Gjithashtu, u theksua nevoja për përfshirjen e të gjithë aktorëve për zhvillimin e qëndrueshëm të kualifikimeve profesionale.

Në pjesën e parë të takimit anëtarët u njohën shkurtimisht me qëllimin e funksionimit dhe pritshmëritë nga veprimtaria e Komitetit Sektorial. Më pas, anëtarët prezantuan institucionet që përfaqësonin, përvojën e tyre profesionale dhe pritshmëritë lidhur me angazhimin në Komitet.

Në vijim, u prezantua Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK), duke u shpjeguar struktura e saj, funksioni në klasifikimin e kualifikimeve dhe lehtësimi i lëvizjes ndërmjet tyre. U nënvizua rëndësia e referencimit me Kornizën Europiane të Kualifikimeve (KEK), e finalizuar në vitin 2021, që mundësoi njohjen e ndërsjellët të kualifikimeve profesionale. Gjithashtu, u vu në pah roli i KSHK-së si bazë për ndërtimin e kualifikimeve në të gjitha format e të nxënies dhe rëndësia e certifikimit të përvojave jashtë sistemit formal. Në përfundim, u evidentua roli i Komitetit Sektorial në procesin e identifikimit dhe validimit të kualifikimeve profesionale në kuadër të KSHK-së, si dhe rëndësia e këtij mekanizmi për zhvillimin e qëndrueshëm të arsimit dhe formimit profesional.

Në vijim të agjendës u kalua në procesin e përzgjedhjes së kryetarit të Komitetit Sektorial të Bujqësisë. Anëtarët propozuan kandidatin, i cili u miratua unanimisht me votim, si një përfaqësues me përvojë në sektor dhe me profil të përshtatshëm për këtë rol.

Në pjesën e tretë të takimi një nga anëtarët e Komitetit Sektorial prezantoi gjetjet e një Studimi të Nevojave për aftësi digjitale dhe të gjelbra në sektorin e bujqësisë, të realizuar vitin e kaluar. Anëtarët u informuan se, në kuadër të Studimit ishte bërë verifikimi në terren, ku ishte konstatuar se sektori bujqësor në Shqipëri karakterizohet nga një heterogjenitet i theksuar: nga njëra anë kompani të mëdha me nivel të lartë zhvillimi dhe investimesh në bujqësinë e gjelbër dhe sidomos në digjitalizim dhe nga ana tjetër, ferma të vogla me kufizime të dukshme strukturore dhe teknologjike. Për realizimin e Studimit ishin kryer 25 intervista cilësore me kompani të mëdha dhe kryesore dhe 172 intervista sasiore.

Anëtarët u informuan se, nga gjetjet e Studimit lidhur me digjitalizimin rezultonte që kompanitë e mëdha kishin një nivel të lartë digjitalizimi, jo vetëm për njohuritë por dhe për investimin në teknologji, ndërkohë që situata ishte krejt e ndryshme për fermerët e vegjël. Fermerët e vegjël kishin njohuri sipërfaqësore për inovacionin dhe konceptet e digjitalizimit dhe situata ishte problematike për përdorimin e sistemeve të informacionit gjeografik dhe teknologjitë GPS.

Megjithatë, u theksua se, potenciali ekzistonte sa kohë sot në Shqipëri ka sera moderne që i përdorin teknologjitë e reja të avancuara.

Lidhur me konceptet e zhvillimit të bujqësisë së gjelbër, anëtarët u informuan se, nga gjetjet e Studimit rezultonte që fermerët dhe paddyshim kompanitë e mëdha kishin njohuri të mira dhe një përdorim të pranueshëm të qarkullimit bujqësor, teknikave të reja të ujitjes, praktikave të mira bujqësore, menaxhimit të mbetjeve bujqësore dhe menaxhimit të fermës, pavarësisht kufizimeve dhe fragmentarizimit të tokës. Po kështu, situata paraqitej pozitive për kompanitë e mëdha lidhur me certifikimet si ai: organik, të cilësisë dhe skemat e tjera të certifikimit, për të cilat niveli i zbatimit të standardeve ishte dukshëm më i lartë dhe pse për fermat e vogla ishin të pa zbatueshme.

Anëtarët u informuan gjithashtu se, nga gjetjet e Studimit rezultonin problematike dhe thuajse aspak të njohura aspektet për bujqësinë organike, praktikat agro-pyjore, masat për mbrojtjen e tokës nga erozioni, mbrojtjen e integruar të bimëve, përdorimin e inputeve bujqësore, ndryshimet klimatike, përdorimin e imazheve satelitore, teknologjitë e informacionit, automatizimit dhe sistemet inteligjente të menaxhimit të fermës, praktikat e mira të kujdesit të kafshëve, përdorimin e të dhënave meteorologjike apo përdorimin e tregtisë elektronike (e-commerce).

Anëtarët u informuan se, Studimi kishte dalë me një sërë rekomandimesh që fillonin nga marrja e masave në nivel mikro deri tek masat që kërkonin ndërhyrje dhe angazhim politik e strategjik. Rekomandimet lidheshin kryesisht me përmirësimin e legjislacionit, strategjive sektoriale, inovacionit dhe standardeve profesionale. Po kështu, u vlerësua e rëndësishme promovimi i bujqësisë së gjelbër dhe digjitalizimit përmes shkollave të mesme profesionale bujqësore, si një nga mënyrat më efektive për të përhapur këto koncepte.

Në pjesën e fundit të takimit, anëtarët u njohën me standardin e profesionit, standardin e kualifikimit profesional dhe skeletkurrikulën për kualifikimin “*Veterinari*”, niveli IV në KSHK. Anëtarët u prezantuan me metodën mbi të cilën hartohen dokumentet, rubrikat që përfshihen në çdo dokument, modelin e përdorur dhe metodologjinë e punës.

Anëtarët dakordësuan me dokumentet e hartuara dhe aprovuan rëndësinë e tyre jo vetëm për përgatitjen e forcës punëtore të kualifikuar në fushë, por edhe për përcaktimin e kriterëve për hyrjen dhe ushtrimin e profesionit që do të siguronte standardizimin në tregun e punës.

Takimi u mbyll me përcaktimin e agjendës për mbledhjen e ardhshme, e cila u la për në muajin shtator. U dakordësua që takimin e ardhshëm të diskutohej për nevojat për aftësi në sektor dhe struktura aktuale e kualifikimeve profesionale në fushën e bujqësisë. Po kështu, u përcaktua prezantimi i një pasqyre të numrit të nxënësve të regjistruar në shkollat bujqësore për vitin mësimor 2026 -2027.

Takimi u përmbyll me falënderime për pjesëmarrjen dhe kontributin e të gjithë anëtarëve.

Vendime të marra nga mbledhja:

- U zgjodh Kryetari i Komitetit Sektorial të Bujqësisë.
- U aprovua skeletkurrikula: “*Veterinari*”, niveli IV në KSHK.